

VENDIM
Nr. 5, datë 13.1.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 196, DATË 22.9.2021, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT KRYESOR TË SHOQËRISË ‘ENERGY PLUS’ SHPK, NËPËRMJET SHITJES SË 100% TË KUOTAVE TË SAJ”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 164/2 prot., datë 29.12.2021, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.9.2021, ‘Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë ‘Energy Plus’ sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 22.9.2021, vendosi:

“1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj.

2. Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.”.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 838/7 prot., datë 27.9.2021.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 0709/2334 prot., datë 16.12.2021, shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, ku janë reflektuar ndryshimet përkatëse, siç përcaktuar dhe në autorizimin e ERE-s.

- Me depozitim të këtij dokumenti rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.9.2021.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.9.2021, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë ‘Energy Plus’ sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

